



Der Ministerpräsident
des Landes Nordrhein-Westfalen



2 nëntor 2020

Liebe Mitbürgerinnen und Mitbürger,

Të dashur bashkëqytetarë dhe bashkëqytetare,
javë të vështira na presin në vazhdim. Nëntori është muaji vendimtar në luftën
kundër valës së dytë të koronavirusit.

Ne kemi vendosur rregulla dhe masa, të cilat e ndryshojnë thellësisht
jetën në Gjermani dhe Nordrhein-Westfalen. Jam i vetëdijshëm se kufizimet
paraqesin një sfidë madhore për shumë njerëz dhe do të çojnë në vështirësi
personale dhe ekonomike.

Prandaj ne kemi nevojë në këto ditë mbi të gjitha për solidaritet. Me të vjetrit dhe të
sëmurët, për të cilët virusi është një rrezik vdekjeprurës. Me personelin e
infirmierëve dhe infermiereve si dhe me mjekët dhe mjeket të cilët arrijnë çdo ditë
në limitet e tyre. Me të shumtët gastronomë, punonjës kulturorë dhe persona të tjerë
të vetëpunësuar, të cilët janë sërish të shqetësuar këto ditë për ekzistencën e tyre
ekonomike.

Nuk duhet të harrojmë qëllimin tonë, se ne po e bëjmë të gjithë këtë, për të mbrojtur
shëndetin e personave më të rrezikuar. Për të mbajtur hapur kopshtet dhe shkollat.
Për të mirëmbajtur jetën ekonomike. Është në dorën e gjithësecilit prej nesh. Në
pandeminë e koronavirusit ne e kemi fatin në dorën tonë: qëndroni në shtëpi.
Duke reduktuar kontaktet tona, ne kemi mundësinë për të frenuar rritjen dramatike të
infeksioneve dhe për të mbrojtur sistemin tonë efikas shëndetësor.

Takoni sa më pak njerëz të jetë e mundur. Përmbajuni rregullave efikase: Mbani
distancën, lani duart, mbani maskat e përditshme.

Por është diçka të cilën nuk duhet t'ia lejojmë vetes ta humbin në këtë kohë
sakrificë: shpresa dhe besimi. Ne do ta kapërcejmë këtë pandemi së bashku. Landi
ynë mund ta bëjë këtë gjë. Le të na japë ky mendim forcën dhe vullnetin e
nevojshëm për t'ia dalë mbanë në javët në vazhdim.

Kujdesuni për veten dhe për njëri-tjetrin.

Qëndroni të shëndetshëm!

Bleiben Sie gesund!
Armin Laschet

Armin Laschet